

L I G J
Nr. 8908, datë 6.6.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8308, DATË 18.3.1998 “PËR TRANSPORTET
RRUGORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Arben Malaj,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 35, rreshti i parë ndryshohet si më poshtë:
“Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë ose i komunës përkatëse”.

Neni 2

Në nenin 36, paragrafi i dytë rreshti i parë, pas fjalëve “Këshilli i bashkisë” shtohen fjalët “dhe këshilli i komunës” .

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3374, datë 24.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani